



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 975/2023
Datë: 30 nëntor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 7 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 10 paragrafi 18 si dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 01/2022 për Përzgjedhjen dhe Përfundimin e Mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, në takimin e mbajtur më datë 30 nëntor 2023, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Znj. Arta Kelmendi, emërohet Drejtor i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.
- II. Mandati i Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë fillon nga data 15 dhjetor 2023 dhe është katër (4) vjeçar me mundësi të riemërimit edhe për një mandat tjetër.
- III. Drejtori i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë i raporton Këshillit dhe Kryesuesit të Këshillit si dhe është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.
- IV. Znj. Arta Kelmendi do të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e saj në bazë të legjislacionit në fuqi.
- V. Znj. Arta Kelmendi, ka të drejtë në beneficionet që rrjedhin nga ushtrimi i pozitës së Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.
- VI. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- VII. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Znj. Arta Kelmendi;
- NJSHPP-së dhe ZKPSH;
- Udhëheqësve të Departamenteve në SKPK;
- Administratorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës;
- Arkivit të KPK-së.